



# EDUKATA ISLAME

PËRMBLEDHJE E SHKURTUAR

IMAMI I FAMSHËM:  
EBU EL UEFA ALI BIN AKIL

Titulli origjinal i librit:

فصول في الآداب  
(*Fusulun fil adabi*)

Titulli në shqip:

**Edukata islame**  
*përmbledhje e shkurtuar*  
**Pajisur me shënime dhe dobi**

Autor:

Imami i famshëm:

**Ebu el Uefa Ali bin Akil**

Përktheu: **Kastriot Bardhi**

Redaktoi: **Klevis Vinjaku**

**Korçë, 2025**

## *Parathënie*

### **Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**

*Të lutem, o Zoti im, lehtësomi veprat e mira dhe mos m'i vështirëso ato!*

*Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve. Paqja, bekimet dhe mëshira e Allahut qofshin për Profetin tonë, Muhamedin, të fundmin e lajmëtarëve dhe prijësin e të devotshëmve, për familjen e shokët e tij, dhe për të gjithë ndjekësit e tyre besnikë deri në Ditën e Gjykimit.*

*Kjo broshurë është një përmbledhje e shkurtuar për edukatën islame, e cila është shkruar nga dijetari i famshëm Ebu el Vefa bin Akil (Allahu e mëshiroftë!).*

## *1. Etika e përshëndetjes islame (selami)*

*Ai që ecën, e përshëndet i pari atë që është i ulur;  
kurse ai që udhëton me mjet, e përshëndet  
këmbësorin dhe atë që rri ulur.<sup>1</sup>*

Shënim: Nga Ebu Hurejra transmetohet, se i Dërguari i All-llahut ( Alejhi-salatu ues-selam) ka thënë: "I hipuri në mjet i jep selam këmbësorit. Këmbësori i jep selam të ulurit dhe pakica i jep selam shumicës."<sup>2</sup>

*Të japësh selam i pari është sunnet (vepër e pëlqyer).*

Shënim: Nga Ebu Umame transmetohet ,se i Dërguari i All-llahut ( alejhi-salatu ue-selam) ka thënë : "Njeriu me më përparësi tek Allahu është ai, që e fillon i pari me selam."<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Fjalët e autorit për efekt dallimi janë të shkruajtura me shkrimin Monotype Corsiva

<sup>2</sup> Transmeton Buhariu dhe Muslimi

<sup>3</sup> Transmetuan Ebu Davudi dhe Tirmidhiu

*Kthimi i selamit është vaxhib (detyrim). Kur nga një grup udhëtarësh apo këmbësorësh jep selam vetëm njëri, kjo përshëndetje është e mjaftueshme për të gjithë. Kur selamin e kthën vetëm njëri, nga një grup njerëzish që rrinë ulur, kjo përshëndetje është e mjaftueshme për të gjithë.*

Shënim: Nga Ali ibn Ebi Talibi përcillet, se Profeti (Alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Mjafton njëri prej një gupi njerëzish të japë selam , ashtu siç mjafton njëri prej të ulurve të kthejë selamin".<sup>4</sup>

*Forma e përshëndetjes me selam është: "Selamun alejkum/ Paqja (e Allahut) qoftë mbi ju!". Kurse mënyra e kthimit është: "Ve alejkumus-selam! / Edhe mbi ju qoftë paqja (e Allahut)!". Është e pëlqyer që të shtohet: "Ve rrahmetu-llahi ue berehatuhu/ mëshira dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ju!". Nuk është e pëlqyer të shtohet më shumë se kaq.*

---

<sup>4</sup> Transmetoi Ebu Davudi

*Preferohet që muslimani ta përshëndesë vëllain e tij musliman me fjalët: "Selamun alejkum ue rrahmetu-llahi!", për t'ia mundësuar atij që e kthen selamin përdorimin e shtesës së pëlqyer "ue berekatuhu".*

*Allahu i Lartësuar thotë: **"Kur ju përshëndet dikush me respekt, kthejani me një përshëndetje më të mirë ose në të njëjtën mënyrë!"** (En-Nisa: 86)*

Shënim: Nga Imran Ibn Husajni shënohet se ka thënë : "Erdhi një burrë te Profeti (Alejhis-salatu ues-selam)dhe tha: "Esselamu ualejkum" Profeti (Alejhis-salatu ues-selam) ja ktheu selamin, u ul dhe tha:"Dhjetë (sevape)". Më pas erdhi një tjetër dhe e përshëndeti: "Esselamu alejkum ue rahmetullah". Edhe këtij ia ktheu selamin, u ul dhe tha: "Njëzet (sevape)".Pastaj erdhi një tjetër dhe përshëndeti:"Esselamu ualejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu." Profeti (alejhis-salatu ues-selam) ia ktheu selamin dhe tha tridhjetë ( sevape)".<sup>5</sup>

---

<sup>5</sup> Transmetuan Ahmedi, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.

*Kur vëllai e përshëndet vëllain, pastaj ata të dy i ndan ndonjë pemë apo ndonjë mur, pastaj takohen sërish, në të tilla raste, i japin përsëri selam njëri-tjetrit. Kështu vepronin shokët e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).*

Shënim: Nga Ebu Hurejra transmetohet se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Kur të takojë ndonjëri prej jush vëllain e tij (musliman), le ti japë selam. Nëse mes atyre të dyve bëhet pengesë një pemë, mur ose gur dhe pastaj takohen, le t'i japë selam."<sup>6</sup>

*Nuk është mirë të përshëndeten femrat reja, sepse ato janë të detyruara ta kthejnë selamin, për pasojë: dëgjohet zëri i tyre, i cili mund të shkaktojë tundim. Sa zëra kanë ndezur epshin dhe ia kanë hapur rrugën imoralitetit! Nuk ka gjë të keqe t'u jepet selam plakave, sepse zëri i tyre nuk ndjell epsh. Të moshuarat kanë nevojë për respekt, të përshëndeten dhe t'u kthehet selami. Në raste të veçanta, kur është e nevojshme, lejohet që grave t'u jepet selam dhe t'u zbulohet fytyra. I tillë është rasti i dëshmisë para organeve të drejtësisë, apo kur ato kryejnë transaksione të ndryshme, siç është*

---

<sup>6</sup> Transmetoi Ebu Davudi

*shitblerja e arit. E gjitha kjo, bëhet për të mbrojtur të drejtën tregtare kontraktore. Është mirë t'u jepet selam të vegjëlve, që atyre t'u mësohet edukata dhe sjellja e mirë, si dhe të shohin zbatimin praktik të vlerave morale në jetën e përditshme.*

Shënim: Nga Enes Ibn Maliku përcillet, se kur kaloi tek disa fëmijë të vegjël u dha selam atyre dhe tha: "Kështu vepronte edhe Profeti (Alejhis-salatu ues-selam)."<sup>7</sup>

*Është e pëlqyer që selami të jepet edhe në hyrje (në takime), edhe në dalje (në ndarje); në hyrje është më i preferuar.*

Shënim: Nga Ebu Hurejra përcillet, se i Dërguari i Allahut ( alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: " Kur të mbërrijë ndonjëri prej jush në kuvend, ku janë ulur njerëz, le të japë selam. Edhe nëse do të çohet prej kuvendit le të japë selam, sepse selami i parë nuk është më parësor se i fundit."<sup>8</sup>

---

<sup>7</sup> Transmetoi Buhariu

<sup>8</sup> Transmetuan Ebu Davudi dhe Tirmidhiu

## *2. Shtrëngimi i duarve dhe përqaqimi*

*Kur takohen dy burra, është e pëlqyer t'ia shtrëngojnë duart njëri-tjetrit.*

Shënim: Nga Bera ibn Azibi transmetohet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Çdo herë që dy muslimanë takohen duke shtrënguar duart e tyre do t'u falen mëkatet para se të ndahen."<sup>9</sup>

*Burrave nuk u lejohet t'ua shtrëngojnë duart femrave të reja.*

Shënim:Nga Umejme bint Rukaja transmetohet se Profeti (Alejhis-salatu ues selam) ka thënë: "Me të vërtetë unë nuk i takoj gratë (e huaja) nëpërmjet dhënies së dorës."<sup>10</sup>

*Lejohet përqaqimi, puthja e ballit dhe e dorës, për nderimin dhe respektimin e njerëzve të fesë dhe të dijes apo të moshuarve muslimanë.*

---

<sup>9</sup> Transmetuan Ebu Davudi dhe Tirmidhiu

<sup>10</sup> Transmetuan Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh

Shënim: Nga Zari' ibn Amir el-Abdiu përcillet, se ka thënë: "Kur mbërritëm në Medinë mes delegacionit të Ibn Kajsit filluam të hidheshim nga mjetet e udhëtimit dhe puthnim dorën e Profetit ( alejhis-salatu ues-selam)."<sup>11</sup> Nga Ibrahim ibn el-Eshathiu shënohet se ka thënë: "E kam parë Sufjan ibn Ujejnën dy herë duke puthur dorën e Fudajl ibn Ijadit."<sup>12</sup>

*Është e pëlqyer që muslimanët të ngrihen në këmbë, kur përshëndesin udhëheqësin e drejtë, prindërit, besimtarët e devotshëm, dijetarët, njerëzit bujarë dhe fisnikë. Nuk preferohet ngritja në këmbë për njerëzit e tjerë, përveç atyre që u përmendën më sipër.*

---

<sup>11</sup> Transmetoi Ebu Davudi.

<sup>12</sup> Transmetoi Ibn Asakiri në "Tarih Dimeshk"

### *3. Bisedat e fshehta dhe ruajtja e sekreteve*

*Nuk i lejohet njeriut të hyjë në mes njerëzve befasisht dhe as në ndonjë bisedë, në të cilën ata nuk e ftojnë.*

Shënim: Nga Abdullah ibn Umeri shënohet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Kur dy vetë flasin më vete mos të futet ndërmjet tyre një i tretë vetëm se me lejën e tyre!"<sup>13</sup>

*Atij nuk i lejohet të dëgjojë fjalët e njerëzve, që bisedojnë fshehtas.*

Shënim: Nga Abdullah ibn Abasi përcillet, se Profeti (Alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Kush dëgjon fjalët e disa njerëzve pa dëshirën e tyre, ose shikon se ata largohen prej tij do t'i hidhet në vesh plumb i shkrirë në Ditën e Gjykimit."<sup>14</sup>

---

<sup>13</sup> Transmetoi Ahmedi

<sup>14</sup> Transmetoi Buhariu

*Kush kthen kokën a trupin duke u rrotulluar prapa ose anash gjatë bisedës së tij<sup>15</sup>, sikur është duke i thënë bashkëbiseduesit se kjo bisedë duhet të mbetet sekret mes nesh, prandaj ai duhet ta ruajë sekretin, sepse lëvizjet e tij të pazakonta shfaqin ndjenja frike e pasigurie.*

Shënim: Nga Xhabir ibn Abdilahi transmetohet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam ) ka thënë:"Kur të flasë një njeri me dikë dhe pastaj largohet duhet ta konsiderojë emanet çka u tha aty."<sup>16</sup>

---

<sup>15</sup> Kjo tregon se ai nuk dëshiron ta dëgjojnë të tjerët. (shën.përkth.)

<sup>16</sup> Transmetuan Ahmedî dhe Ebu Davudi

#### *4. Për mendjemadhësinë*

*Mendjemadhësia është sjellje e shëmtuar.*

Shënim: Nga Abdullah ibn Mes'udi transmetohet, se Profeti (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Nuk do të futet në Xhenet ai që ka në zemrën e tij një grimcë prej mendjemadhësisë." Dikush pyeti: " Po kur njeriu dëshiron të ketë robë dhe këpucë të mira." Ai (alejhis-salatu ues-selam) tha: "Vërtet Allahu është i Bukur dhe e do bukurinë. Mendjemadhësi është atëherë kur refuzon të vërtetën dhe nënçmon njerëzit."<sup>17</sup>

*Nuq lejohet ecja me kërenari të sëmurë. Muslimani e shfaq modestinë edhe në ecje.*

Shënim: Allahu i Lartësuar thotë: "Mos ec nëpër tokë me mendjemadhësi, se ti, në të vërtetë, nuk mund ta çash tokën e as të arrish lartësinë e maleve."<sup>18</sup>

*Allahu i urren fodullët dhe arrogantët.*

---

<sup>17</sup> Transmetoi Muslimi

<sup>18</sup> Kuran, 17:37

Shënim: Allahu i Lartësuar thotë: “Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët!”<sup>19</sup>

### ***5. Morali i zemërgjerësisë (anashkëlimi i gabimeve të të tjerëve)***

*Anashkëlimi i gabimeve të të tjerëve është vlerë e lartë morale. Gabimi është pjesë e natyrës njerëzore. Njeriu gabon me ose pa qëllim, por ai ndihet keq kur të tjerët ia përhapin të metat. Prandaj, domosdoshmërisht, duhet të tregohemi të shkujdesur ndaj gabimeve të njerëzve, në mënyrë që të mos i vëmë ata në pozitë të vështirë. Mendjet e ndriçuara dhe zemrat e mëdha janë mjeshtrë të moralit të zemërgjerësisë.*

Shënim: Nga Ebu Hurejra transmetohet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Kush i mbulon të metat e një muslimani, Allahu do të mbulojë të metat e tij në këtë botë dhe botën e Ahiretit."<sup>20</sup>

---

<sup>19</sup> Surja Lukman ajeti 18.

<sup>20</sup> Transmeton Muslimi

## ***6.Sunetet e Fitras<sup>21</sup>***

*Dhjetë gjëra janë nga Fitra: Pesë kanë lidhje me kokën dhe pesë të tjerat me trupin.*

Shënim: Nga Aishja transmetohet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë:"Dhjetë gjëra janë nga Fitra(natyrshmëria e pastër e përcjellur nga profetët):Shkurtimi i mustaqeve, lëshimi i mjekrrës, përdorimi i misvakut, shpëlarja e hundëve, shkurtimi i thonjve, larja mes nyjeve të gishtave, heqja e qimeve në sqetull, rruajtja e qimeve në organet gjenitale dhe pastrimi pas kryerjes së nevojave personale." Transmetuesi tregon, se e ka harruar të dhjetën, por mendon se ajo është shpëlarja e gojës. <sup>22</sup>

*Ato që kanë lidhje me kokën janë: larja e gojës, shpëlarja e hundëve, përdorimi i misvakut, shkurtimi i mustaqeve dhe lëshimi i mjekrrës.*

Dobi: Nga Aishja transmetohet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Përdorimi i misvakut është pastrim për gojën dhe kënaqësi për

---

<sup>21</sup> Fitra: natyrshmëria e pastër; sunetet e Fitras janë prej traditës së profetëve.

<sup>22</sup> Transmetoi Muslimi

Zotin."<sup>23</sup> Rastet kur preferohet të përdoret misvaku janë: para marjes së abdesit apo përpara faljes së namazit. Transmetohet nga Ebu Hurejra se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Sikur mos ta rëndoja popullin tim do t'i kisha urdhëruar të përdornin misvakun në çdo abdes."<sup>24</sup> Po ashtu preferohet përdorimi i misvakut kur zgjohesh nga gjumi. Nga Ibn Umeri shënohet se ka thënë:"I Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) sa herë që flinte e mbante misvakun pranë tij dhe kur zgjohej fillonte duke pastruar dhëmbët me misvak."<sup>25</sup> Nga Hudhejfe shënohet, se ka thënë:"I Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) kur çohej natën e pastronte gojën e tij me misvak."<sup>26</sup> Misvaku preferohet të përdoret përpara leximit të Kuranit. Aliu transmeton se Profeti (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë : "Pastrojeni gojën tuaj për Kuranin"<sup>27</sup>Aishja transmeton se Profeti (alejhis-salatu ues-selam) "sapo hynte në shtëpi

---

<sup>23</sup> Transmetuan Ahmedi dhe Nesaiu

<sup>24</sup> E ka nxjerr Maliku, Ahmedi dhe Nesaiu. E ka saktësuar Ibën Huzejme.

<sup>25</sup> Transmetuan Ahmedi dhe Ebu Ja'la

<sup>26</sup> Transmetuan Buhariu dhe Muslimi

<sup>27</sup> Hadithin e përcjell ibn Huzejme.

merrte të përdorte misvakun."<sup>28</sup>Përsa i përket lëshimit të mjekrrës dhe shkurtimit të mustaqeve nga Ebu Hurejra transmetohet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Bëni ndryshe nga zjarrputistët! Shkurtojini mustaqet dhe lëshoni mjekrat!"<sup>29</sup>

*Ndërsa gjërat që kanë lidhje me trupin janë: rruajtja e qimeve në organet gjentiale, heqja e qimeve nga sqetullat, prerja e shkurtimi i thonjve, pastrimi me ujë pas kryerjes së nevojave personale dhe sunetllëku (rrethprerja).*

Dobi: Enesi thotë: "I Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) na caktoi, që për shkurtimin e mustaqeve, thonjve dhe për rruarjen e qimeve në vendet e turpshme të mos kalojnë 40 ditë"<sup>30</sup>

---

<sup>28</sup> Hadithin e përcjell Muslimi

<sup>29</sup> Transmetoi Muslimi

<sup>30</sup> Transmetoi Muslimi

### ***7. Për shkëlqjen e thinjave dhe rruajtjen e pjesës së poshtme të kokës (zverkut-qafës)***

*Shkëlqja e thinjave është vepër e qortueshme. Thinjat janë dinjitet; ato janë dritë e muslimanit. Gjithashtu thinjat paralajmërojnë vdekjen; ato të kujtojnë se je i përkohshëm në këtë botë dhe se takimi me Allahun është afër, kështu që të nxisin për vepra të mira dhe të largojnë nga gjynahet.*

Shënim: Nga Abdullah ibn Amr ibn el -Asi transmetohet, se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Mos i shkëlqeni thinjat. Çdo muslimani që i del një thinjë në qimet e tij do ta ketë dritë atë në Ditën e Gjykimit."<sup>31</sup>

*Nuk është e pëlqyeshme rruajtja e pjesës së poshtme të kokës (zverkut-qafës), përveç rastit kur dëshiron të bësh hixhame apo në ndonjë rast tjetër të ngjashëm me të.*

Shënim: Nga Ibn Umeri transmetohet, se ka thënë: "I Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) e ka ndaluar të rruhet vetëm një pjesë e kokës."<sup>32</sup>

---

<sup>31</sup> Transmetuan Ebu Davudi dhe Tirmidhiu

<sup>32</sup> Transmetuan Buhariu dhe Muslimi

### **8. Kërkitimi i lejës**

*Askush nuk duhet të hyjë befasisht, pa marrë lejë, tek të afërmit apo të largët, që të mos i gjejë në gjendje të papërshtatshme e të padëshirueshme, siç është zbulimi i pjesëve intime etj.*

Shënim: All-llahu i Lartësuar thotë: "O ju që besuat, mos hyni në shtëpi të huaja pa kërkuar leje dhe pa përshëndetur njerëzit e saj. Kjo është më mirë për ju në mënyrë që merrni mësim. Po nëse nuk gjeni aty asnjë, atëherë mos hyni në to derisa t'u jepet leja, e nëse u thuhet kthehuni, ju pra kthehuni. Kjo është më e ndershme për ju. All-llahu di çdo gjë që veproni ju."<sup>33</sup> Nga Sehl ibn S'ad transmetohet, se i Dërguari i Allahut (alejhissalatu ues-selam)ka thënë : "Me të vërtetë leja kërkohet për shkak të shikimit."<sup>34</sup>

### **9. Kuvendimi ndërmjet dy a më shumë vetave duke përjashtuar të tjerët**

*Nuk lejohet biseda e fshehtë ndërmjet dy a më shumë vetave duke përjashtuar të tjerët, sepse kjo u thyen zemrën dhe i ofendon rëndë.*

---

<sup>33</sup> Surja En-Nur ajetet 27-28

<sup>34</sup> Transmetuan Buhariu dhe Muslimi

Shënim: Nga Abdullah ibn Mes'udi transmetohet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Kur të jini tre vetë bashkë, mos të pëshpërisin dy prej jush duke lënë veçmas të tretin derisa të përziheni me njerëz të tjerë, në mënyrë që të mos mërzhitet."<sup>35</sup>

### *10. Edukata e ngrënies dhe e pirjes*

*Është e pëlqyer që muslimani ta përmendë emrin e Allahut (duke thënë "Bismil-lah"), kur fillon të hajë ushqimin; dhe e përfundon atë duke e falënderuar Allahun (me fjalët "el-hamdulil-lah").*

Shënim: Nga Aishja transmetohet se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Kur të hajë ndonjëri prej jush le të përmendë emrin e Allahut e kur të harojë le të thotë gjatë ushqimit: "Bismil-lah euueluhu ue ahirehu (Me emrin e Allahut në fillim dhe mbarim)."<sup>36</sup> Përsa i përket falënderimit të Allahut të Lartësuar pas ngrënies ushqimit dhe pijes argument për këtë është hadithi i Enes Ibn Malikut (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili ka thënë: "I Dërguari i Allahut

---

<sup>35</sup> Transmetuan Buhariu dhe Muslimi

<sup>36</sup> Transmetuan Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.

(alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Me të vërtetë Allahu është i kënaqur me robin i cili kur të hajë ndonjë ushqim e falënderon Allahun për të, ose kur të pijë ndonjë pije e falënderon Allahun për të."<sup>37</sup> Nga Muadh ibn Enesi përcillet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Kush ha ushqim dhe pastaj thotë:" Elḥamdu lil-lāhil-ledhĩ eṭ'amenĩ hādhā ue razeḱanĩhi min ğajri ḥaulin minnĩ ue lā ḱuuueh! (Lavdia i takon Allahut, i Cili më ushqeue dhe më furnizoi me këtë ushqim, pa asnjë manovrim nga unë dhe pa aspak fuqi të timen) do t'i falen mëkatet e mëparshme."<sup>38</sup>

*Muslimani ha ushqim me dorën e djathtë dhe ha atë që ka përpara.*

Shënim: Nga Umer ibn Ebi Selemeh transmetohet, se ka thënë: "Isha fëmijë i vogël nën kujdesin e Profetit (alejhis-salatu ues-selam) dhe dora ime qarkullonte nëpër enë kur hanim, dhe ai më tha:"O djalosh! Përmende emrin e Allahut në ushqim(bismil-lah), ha me të djathtën, dhe ha atë që ke përpara." Kjo ka vazhduar të ishte mënyra e ngrënies sime më pas."<sup>39</sup>

---

<sup>37</sup> Transmetoi Muslimi

<sup>38</sup> Transmetuan Ahmedi , Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.

<sup>39</sup> Transmetuan Buhariu dhe Muslimi

*Nuk është e pëlqyeshme ngrënia e pirja në këmbë dhe as duke u mbështetur. Kur i silltet ena me ujë apo ushqim, fillimisht i jep (i shërben) personit që gjendet në të djathtë të tij. Kështu ka vepruar Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Është e papëlqyeshme të pihet ujë në pjesën e thyer të grykës së enës.*

Shënim: Nga Ebu Seid El Hudriu shënohet se ka thënë: "E ka ndaluar i Dërguari i Allahut (alejhissalatu ues-selam) pirjen në pjesën e çarë të enës dhe të lëshohet fryma në enë."<sup>40</sup>

### ***11. Të tjera rregulla që kanë lidhje me ngrënien e ushqimit***

*Është e preferueshme larja e duarve para dhe pas ngrënies së ushqimit, veçanërisht kur janë me yndyrë mishi, bulmeti etj. Është mirë të lahen duart, kur ato mbajnë aromë të pakëndshme, sidomos para gjumit.*

Shënim: Nga Ebu Hurejra përcillet, se Profeti (Alejhissalatu ues-selam) ka thënë: "Kush fle me duar me yndyrë mishi pa i larë mos të fajësojë askënd përveç

---

<sup>40</sup> Transmetuan Ahmedi dhe Ebu Davudi

vetes nëse e gjen gjë e keqe."<sup>41</sup>

*Në traditën profetike muslimani këshillohet që të bëjë kujdes nga parazitët. Kush do të shkojë në xhami apo të izolohet në të (të hyjë në itikaf), nuk duhet të hajë perime me aromë të keqe, si: qepë, hudhra dhe presh. Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i ka ndaluar nga frekuentimi i xhamisë ata që i hanë këto perime, në mënyrë që të mos i shqetësojnë dhe bezdisin të tjerët.*

Shënim: Nga Xhabir ibn Abdilahi shënohet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Kush ha hudhër ose qepë të largohet prej nesh, ose të largohet nga xhamitë tona, e të qëndrojë në shtëpi."<sup>42</sup>

---

<sup>41</sup> Transmetuan Ahmedi, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu

<sup>42</sup> Transmetuan Buhariu dhe Muslimi.

### *12. Prej normave të sjelljes brenda shtëpisë...*

*Para se të flejë gjumë, muslimani e mbyll derën, e lidh grykën e calikut, e mbulon enën dhe e fik kandilin. Kjo është përcjellë në traditën profetike.*

Shënim: Prej sunetit është që, kur vjen nata, të mbulohen enët e zbuluara dhe të mbyllet gryka e enës me pije, nëse ajo ka mbyllëse, duke e përmendur emrin e Allahut. Argument për këtë është hadithi i Xhabir ibn Abdullahut (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili ka thënë se kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) të thotë: "Mbulojini enët dhe mbylleni grykën e enës me pije. Në të vërtetë, gjatë vitit është një natë në të cilën zbret epidemia. Kjo epidemi prek çdo enë (që përmban ushqim a pije) pa kapak."<sup>43</sup> Nga Xhabir ibn Abdilahi përcillet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-salam) ka thënë: "Kur të flini gjumë fikni kandilat, kyçni dyert, mbyllni enët, mbulojini ushqimet dhe pijet!"<sup>44</sup>

---

<sup>43</sup> Transmeton Muslimi. Shkëpurur nga libri "Praktikat dhe lutjet e përditshme të Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të) i autorit Dr. Abdullah ibn Hamud el-Foriih fq.131

<sup>44</sup> Transmetoi Buhariu

### *13.Për gostinë*

*Muslimani i përgjigjet ftesës, kur ftohet në dasmë. Kështu pra, kush ftohet në gostinë e dasmës, duhet t'i përgjigjet ftesës.*

Shënim: "Përgjigjia e ftesës së dasmës është detyrë, prandaj nëse thiret dikush në dasëm nuk lejohet të mos prezantojë pa arsye."<sup>45</sup> Nga Abdullah ibn Umeri përcillet se Profeti (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë:"Kur të ftohet dikush prej jush në dasëm le t'i përgjigjet ftesës."<sup>46</sup>

*Nëse nuk është me agjërime, le hajë ushqim; dhe nëse është me agjërime, le të lutet.*

Shënim: Reth kësaj tematike kemi dy hadithe. Nga Ebu Hurejra transmetohet, se i Dërguari i All-llahu (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Kur të ftohet ndonjëri prej jush për të ngrënë le t'i përgjigjet ftesës, në qoftë se është me agjërime le të lutet, e nëse nuk

---

<sup>45</sup> Shkëputur nga libri "Etika dhe normat Islame" i autorit Mustafa Terniqi fq.233

<sup>46</sup> Transmetoi Muslimi

është me agjërime le të hajë."<sup>47</sup> Ebu Seid el-Hudriu rrëfen:" I përgatita të Dërguarit të Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ushqim dhe ai erdhi bashkë me shokët e tij dhe kur u shtrua ushqimi, njëri prej tyre tha:"Unë jam me agjërime." Profeti (Alejhis-salatu ues-selam) i tha:" Ju ka ftuar vëllai juaj dhe është harxhuar për ju!" Pastaj tha:"Prishe agjërime dhe agjëro një ditë tjetër në vend të kësaj nëse ke dëshirë!"<sup>48</sup>

**Dobi:** "Në qoftë se i ftuari është me agjërime mund ta pranojë ftesën dhe është i lirë për ta prishur agjërime, nëse është agjërime vullnetar ; ose ta mbajë atë, por gjatë qëndrimit bën dua për mikpritësin, që e ftoi dhe të pranishmit. Më e pëlqyer është ta prishë agjërime dhe ta zvëndësojë më pas, nëse ka dëshirë përderisa nuk është agjërime farz. Kurse për agjërime farz duhet ta mbajë dhe mjafton të shkojë dhe të lutet për ta."<sup>49</sup>

*Sigurisht, i përgjigjet ftesës dhe merr pjesë në një gosti ku nuk ka gjëra të ndaluara. Ndërsa kur në të ka haramë, nuk lejohet të marrë pjesë. Nëse në gosti ka gjëra të papëlqyera, kritikohet pjesëmarrja në të.*

---

<sup>47</sup> Transmetoi Muslimi

<sup>48</sup> Transmetoi Bejhaku

<sup>49</sup> Shkëputur nga libri "Etika dhe normat Islame" i autorit Mustafa Terniqi fq 311

### 15. Përgojimi

Përgojimi është haram. Nuk lejohet të merret nëpër gojë mëkatari që nuk bën gjynahe haptas. Allahu i Lartësuar thotë:

**“Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin!”** (El Huxhurat:12)

Në disa raste lejohet që të flitet keq për mëkatarin, për të përmirësuar sjelljen e tij dhe për dobi të tjera, por pa shkaktuar dëme. Disa nga këto raste janë: kur mëkatari i publikon gjynahet dhe njerëzve u duhet tërhequr vëmendja që të ruhen prej tij, kur dikush të pyet për një person të caktuar për martesë, marrëdhënie pune apo bashkëpunime të ndryshme. Në këto raste - dhe të tjera të ngjashme me to - është detyrë që të tregohet qartë gjendja e mëkatarit. Kjo nuk konsiderohet përgojim. Në këto raste, jo vetëm që nuk është gjynah zbulimi i realitetit të mëkatarit, por për më tepër, personi që bën një gjë të tillë merr shpërblimin e dhënies së këshillës. Kur Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) propozoi 6 veta prej sahabëve, për të zgjedhur më të mirin e tyre si udhëheqës të muslimanëve, ai përmendi të metat e secilit prej tyre. Nuk mund të imagjinohet që Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) të kishte për qëllim përgojimin e shokëve të tij në atë kuvend e konsultim, por dëshiroi të

*këshillojë për hir të Allahut, duke zbatuar porositë e të Dërguarit të Tij, për të mirën e Islamit dhe të muslimanëve. Ndërsa përgojuesi nuk ka qëllim të mirë. Ai i përmend të metat dhe mangësitë duke dashur të turpërojë e të nënçmojë personin që merr nëpër gojë.*

### **16. Vlera e heshtjes**

*Muslimani duhet ta ruajë dhe ta kontrollojë gjuhën; të heqë dorë nga fjalët e padobishme; të flasë vetëm për gjërat që i interesojnë, për të cilat duhet të flitet patjetër.*

Shënim: Nga Ebu Hurejre transmetohet, se i Dërguari i Allahut (alejhiss-salatu ues-selam) ka thënë: "Kush ka besuar Allahun dhe Ditën e Gjykimit le të flasë të mirën ose të heshtë."<sup>50</sup>

*Më e mirë se heshtja është të folurit për gjëra që i bëjnë dobi atij vetë apo të tjerëve, si p.sh.: këshilla dhe nxitja për vepra të mira, promovimi i vlerave, parandalimi i të këqijave, pajtimi i njerëzve, përmendja e Allahut, leximi i Kuranit, mësimi i fesë, si dhe të tjera fjalë e vepra të ngjashme me këto.*

---

<sup>50</sup> Transmetuan Buhariu dhe Muslimi

Shënim: Nga Tavusi tregohet, se i ka thënë Ebu Naxhih el-Mekit, që ishte aty prej tabiinëve: "O Ebu Naxhih! Kush flet duke e pasur droje Allahun është më i mirë se ai që hesht e nuk e ka droje Atë."<sup>51</sup>

### *17. Për rregullat e veshjes*

*Veshja e mëndafshit është e ndaluar për burrat dhe e lejuar për gratë.*

Shënim: Nga Ebu Musa transmetohet se i Dërguari i Allahut (alejhissalatu ues-selam) ka thënë: "Ari dhe mëndafshi janë të ndaluara për meshkujt e umetit tim dhe të lejuara për femrat e këtij umeti."<sup>52</sup>

*Gjithashtu stolisja me ar është haram për burrat, madje edhe unaza që përmban sasi të vogël ari është e ndaluar. Lejohet, nuk ka problem, përdorimi i mëndafshit, kur ai është në sasi të papërfillshme, e cila nuk bie në sy.*

Shënim: Nga Ebu Hurejra transmetohet, se Profeti (alejhissalatu ues-selam) e ka ndaluar unazën prej

---

<sup>51</sup> Transmetoi Fakihi në "Akhbar Mekke".

<sup>52</sup> Transmetuan Tirmidhiu dhe Nesaiu

ari." <sup>53</sup> Nga Abdullah ibn Abasi përcillet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) pa një unazë ari në dorën e një burri, të cilën ia hoqi, ia flaku tej dhe tha: "Mos vallë kërkon ndonjëri prej jush të vendosë në dorën e tij prush prej zjarri?" Pasi iku Profeti (Alejhis-salatu ues-selam) i thanë atij: "Merre unazën se mund të vlejë për ndonjë gjë tjetër." "Jo pasha Allahun!" - u përgjigj ai, -Nuk e marr më kurrë një gjë, që e ka flakur tej i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam)."<sup>54</sup>

*Nuk lejohet veshja e rrobave që kanë figura gjallesash, njerëz apo kafshë qofshin, as fotot e kësaj natyre që varen në mur. Profeti (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Engjëjt nuk hyjnë në ato shtëpi, ku ka qen apo foto të krijesave me shpirt."<sup>55</sup>*

---

<sup>53</sup> Transmetuan Buhariu dhe Muslimi

<sup>54</sup> Transmetoi Muslimi

<sup>55</sup> Transmetuan Buhariu dhe Muslimi

### ***18. Për mbajtjen e unazës***

*Siç u përmend më sipër, mbajtja e unazës prej ari është e ndaluar kategorikisht për meshkujt dhe e lejuar për gratë. Preferohet që unaza të vendoset në dorën e majtë, por mund të mbahet edhe në dorën e djathtë.*

Shënim: Për të dyja rastet ka argument. Nga Enesi shënohet se ka thënë: "Profeti (Alejhis-salatu ues-selam) e vendoste unazën këtu, dhe bëri me shenjë në gishtin e vogël të dorës së majtë."<sup>56</sup> Nga Abdullah ibn Xhaferi përcillet se Profeti (alejhis-salatu ues-selam) e vendoste unazën në dorën e djathtë.<sup>57</sup>

***19. Lëshimi i pantallonave përtej nyjave të këmbëve***  
*Lëshimi i pantallonave poshtë kyçeve të këmbëve është haram. Askujt nuk i lejohet të tërheqë rrobat zvarrë me arrogancë e mendjemadhësi.*

Shënim: Nga Ebu Hurejra transmetohet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Çdo rrobe që zbret poshtë nyjes së këmbëve është në Zjarr."<sup>58</sup> Nga Abdullah ibn Umeri transmetohet se i

---

<sup>56</sup> Transmetoi Muslimi

<sup>57</sup> Transmetuan Ebu Davudi dhe Tirmidhiu

<sup>58</sup> Transmetoi Buhariu

Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Allahu nuk do ta shikojë në Ditën e Gjykimit atë që e lëshon rroben e tij përdhe, duke mos pasur qëllim tjetër përveç mendjemadhësisë."<sup>59</sup>

### ***20. Ngjyrosja e flokëve dhe e mjekrës***

*Është e pëlqyeshme ngjyrosja e flokëve dhe e mjekrës me këna ose ketm<sup>60</sup>. Është e papëlqyeshme lyerja me ngjyrë të zezë.*

Shënim: Nga Xhabir ibn Abdilahi shënohet se ka thënë: E sollën Ebi Kuhafen në ditën e çlirimit të Mekës dhe qimet e kokës dhe të mjekrës i ishin bërë si shkurre të bardha, prandaj i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) tha: "Ndryshojeni (lyejini) këto qime me diçka, por shmangeni ngjyrën e zezë!"<sup>61</sup>

---

<sup>59</sup> Transmetoi Muslimi

<sup>60</sup> Është një ngjyrë ndërmjet të zezës dhe të kuqes, që anon nga kjo e fundit.

<sup>61</sup> Transmetoi Muslimi

*21. Veçimi i mashkullit me një femër të huaj*  
*Është kategorikisht e ndaluar që mashkulli të veçohet me një femër të huaj në një vend, ku as e shikojnë dhe as e dëgjojnë të tjerët, teksa ajo nuk ka pranë asnjë mashkull nga familja e saj.*

Shënim: Nga Umer ibn Hatabi shënohet, se Profeti (Alejhissalatu ues-selam) ka thënë: "Mos të veçohet askush prej jush me ndonjë femër, sepse i treti do të jetë shejtani." <sup>62</sup>Nga Abdullah ibn Abasi transmetohet, se e ka dëgjuar Profetin (alejhissalatu ues-selam) duke thënë: "Mos të veçohet një burrë me një grua vetëm nëse ajo është me kujdestarin e saj dhe mos të udhëtojë gruaja vetëm pa pasur kujdestar." <sup>63</sup>

*Nuk lejohet që dy burra të rrinë bashkë të zhveshur në të njëjtin shtrat, dhe as dy gra; sikurse nuk lejohet që ata të mbulohen me një batanije të përbashkët.*

---

<sup>62</sup> Transmeton Ahmedi dhe Tirmidhiu

<sup>63</sup> Transmetuan Buhariu dhe Muslimi

Shënim: Ebu Said el Khudri – Allahu qoftë i kënaqur prej tij – tregon se Profeti (alejhissalatu ues-selam)ka thënë: “Të mos futet burri me një burrë tjetër poshtë një mbulese dhe as gruaja me një grua tjetër poshtë një mbulese”<sup>64</sup>

## ***22.Për lojën dhe dëfrimin***

*Nuk lejohet pjesmarrja në lojëra të ndaluara dhe ahengje ku ka shthurje e degjenerim, në atmosferën e muzikës dhe veglave muzikore, si: daullja etj. Në dasmë lejohet vetëm përdorimi i defit, sepse Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: “Shpalleni martesën, dhe në dasmë bjerini defit.”*

---

<sup>64</sup> E transmeton Muslimi.

### ***23. Për rukjet***

*Për shërimin e të sëmurëve apo parandalimin e sëmundjeve lejohen rukjet (yshtjet), ku lexohen ajetet kuranore, përmenden emrat e Allahut të Lartësuar dhe cilësitë e Tij, si dhe përdoren lutje të ndryshme, nëpërmjet të cilave i kërkohet ndihmë dhe mbrojtje Allahut.*

Shënim: Rukjet janë leximi i ajeteve kuranore dhe lutjeve për të sëmurët, më qëllim shërimin e tyre ose parandalimin e sëmundjeve. Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) pohon se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e ka lejuar rukjen... (Muslimi) Ekziston dakortësi për lejimin e rukjeve. Mendimi më i saktë është se rukja është e pëlqyer, për shkak se Xhibrili (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka bërë rukje, siç përcillet në hadithin e Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Po ashtu, edhe vetë Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka bërë rukje, sikurse transmetohet nga Buhariu dhe Muslimi. Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) na tregon se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kur sëmurej i lexonte vetes ajete kuranore dhe lutje duke i fryrë trupit. Kur u përkeqësua dhe dhimbjet iu shtuan

shumë, ajo i lexonte dhe e prekte me dorën e tij duke shpresuar në bekimin e saj.

Dijetarët (Allahu i mëshiroftë!) kanë përmendur disa kushte për lejimin e rukjeve:

1- Të mos përmbajnë shirk.

2- Të besohet se ato nuk mund të ndikojnë vetvetiu, por vetëm se me caktimin e Allahut.

3- Duhet që rukja të jetë me fjalë të kuptueshme, sepse fjalët e pakuptueshme me shumë mundësi përmbajnë kufër dhe shirk.

4- Nuk lejohet të shkohet tek fallxhorët apo magjistarët për të bërë rukje.

5- Nuk lejohet që rukja të shfaqet në formë të ndaluar, si p.sh.: në rastin kur njeriu do të bëjë rukje në gjendje të papastër (kur është xhunub) ose në varreza, ose në banjë, ose kur është duke vrojtuar yjet etj.

6- Të besohet se rukja është thjesht një prej shkaqeve të lejuara.<sup>65</sup>

---

<sup>65</sup> Shkëputur nga libri "Përmbledhje e besimit Islam" i autorit Prof.Dr.Halid ibn Ali el Mushejkih fq.90-91

## *24. Diçka për mjekimin*

*Për t'u kuruar nga sëmundjet lejohet përdorimi i hixhames dhe flebotomisë<sup>66</sup>; sikurse lejohet mjekimi me hekur të nxehtë dhe pirja e ilaçeve.*

Shënim: Nga Enes Ibn Maliku transmetohet, se Profeti (Alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Vërtet kurimi më i mirë për ju është hixhamja (nxjerja e gjakut të keq nga trupi me kupa)."<sup>67</sup>Nga Usama ibn Sheriku transmetohet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Kurohuni o robërit e Allahut, sepse Allahu i Lartësuar për çdo sëmundje bashkë me të ka zbritur dhe ilaçin përveç vdekjes dhe plakjes."<sup>68</sup>

*Nuk lejohet trajtimi i sëmundjeve me gjëra të ndaluara dhe të papastra.*

Shënim: Nga Abdullah ibn Mes'udi përcillet, se ka thënë: "Vërtet Allahu nuk e ka bërë shërimin tuaj në gjërat e ndaluara për ju."<sup>69</sup>

---

<sup>66</sup> Mjekimi përmes nxjerrjes së gjakut nga venat, që ngjan shumë me hixhamen.

<sup>67</sup> Transmetuan Buhariu dhe Muslimi

<sup>68</sup> Transmetoi Ahmedi, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu

<sup>69</sup> Transmetuan Buhariu, Abdurrezaku dhe Ibn Ebi Shejbe.

### *25. Për vrasjen e gjarpërinjëve*

*Kush gjen ndonjë gjarpër në shtëpinë e tij, nuk lejohet ta vrasë pa i kërkuar atij tri herë që të largohet nga shtëpia. Nëse gjarpëri nuk largohet, atëherë vritet. Përrjashtim bëjnë dy lloje prej gjarpërinjëve të shtëpisë, të cilët vriten pa iu kërkuar të largohen nga shtëpia. Këta të dy janë: dhut-Tufjetejni<sup>70</sup> dhe el Ebteru<sup>71</sup>. Gjarpërit i kërkohej të largohet nga shtëpia duke i thënë: "Shko në paqe!"*

### *26. Për vrasjen e disa kafshëve*

*Lejohet vrasja e zhapikëve. Nuk lejohet vrasja e milingonave dhe as prishja e foleve të tyre. Është e papëlqyeshme djegja e morrave me zjarr. Nuk lejohet vrasja e bretkosave, sepse Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e ka ndaluar vrasjen e tyre.*

Shënim: Nga Ebu Hurejra shënohet, se Profeti (alejhissalatu ues-selam) ka thënë: "Kush vret një hardhuce me goditje të parë do t'i shkruhen njëqind të mira. Në

---

<sup>70</sup> Ky gjarpër dallohet nga të tjerët përmes dy vijave të zeza që ka në shpinë.

<sup>71</sup> Është i trashë dhe me bisht të shkurtër.

qoftë se e vret me goditjen e dytë do t'i shënohen më pak, e nëse e vret me goditjen e tretë do t'i shënohen më pak."<sup>72</sup>

### *27. Për pastrimin e xhamive*

*Xhamitë janë shtëpitë e Allahut. Duhet të kujdesemi për ruajtjen e pastërtisë së tyre. Në to nuk lejohet prerja e thonjve, shkurtimi i mustaqeve etj. Nga xhamitë duhet larguar çdo pisllek e papastërti. Në xhami nuk lejohet kërkimi i gjësë së humbur dhe as shitblerja. Po ashtu është papëlqyeshme kryerja e punëve dhe ushtrimi i zejeve, si: qepja e rrobave, punimet artizanale nga pambuku etj, si këto, nëse ato janë shumë. Kurse po të jenë pak, nuk ka problem, si p.sh.: arnimi i rrobës dhe qepja e rripit të sandaleve.*

Shënim: Urrehet kërkimi i gjësë së humbur dhe shitblerjes në xhami. Muslimi në Sahihun e tij përcjell se Profeti (SalAllahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kë të dëgjoni që kërkon sendin e tij të humbur në xhami, thuajini: Allahu mos e ktheftë atë gjë tek ti, sepse xhamitë nuk janë ngritur për këto gjëra.” Profeti (SalAllahu alejhi ue selem) ka thënë: “Kë të dëgjoni ndonjërin që po kryen shitblerje në xhami, i thoni: Allahu mos i dhëntë fitim tregtisë tënde.”<sup>73</sup>

---

<sup>72</sup> Transmetoi Muslimi

<sup>73</sup> E përcjell Tirmidhiu, ndërsa Albani e konsideron si hadith të saktë.

## *28. Për treditjen dhe damkosjen e bagëtive*

*Nuk lejohet treditja e bagëtive dhe as damkosja e tyre.*

Shënim: Nga Xhabir Ibn Abdilah tregohet se dikush kaloi përpara Profetit (alejhis-salatu ues-selam) me një gomar të damkosur në fytyrë në ç'rast tha: "A nuk e keni marrë vesh, se unë i kam mallkuar ata që i damkosin dhe i godasin kafshët në fytyrë?"<sup>74</sup>

*Damkosja e bagëtive lejohet vetëm në raste të veçanta, siç është: trajtimi veterinar ose kur atyre u vihet ndonjë shenjë për t'i dalluar nga të tjerat, në rast se është e nevojshme të bëhet një gjë e tillë.*

---

<sup>74</sup> Transmetoi Ebu Davudi

## ***29. Nderimi dhe respektimi i prindërve***

*Respektimi i prindërve është detyrë. Nuk lejohet bindja ndaj tyre në mosbindje ndaj Allahut të Lartësuar. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: “Nuk ka bindje ndaj krijesës kur kundërshtohet Krijuesi.”<sup>75</sup>*

Shënim: Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vjetësh. Ne i thamë atij: “Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë” Nëse ata orvaten, që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo, por sillu mirë me ata në këtë jetë dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë me devotshmëri; pastaj, tek Unë do të ktheheni dhe Unë do t’ju lajmëroj për atë që keni bërë.<sup>76</sup>

---

<sup>75</sup> Transmetoi Muslimi

<sup>76</sup> Surja Lukman 14-15

### *30. Prej edukatës së qëndrimit ulur dhe lutja për shlyerjen e gjynaheve, kur mbaron takimi a kuvendi*

*Nuk është e pëlqyeshme që të vendosësh dorën e majtë pas shpine poshtë të ndenjurrave dhe të mbështetësh në të; sikurse nuk lejohet të qëndrosh në një vend ku një pjesë e trupit është në diell dhe pjesa tjetër në hije.*

Shënim: Këto ndalesa bazohen në dy hadithet e mëposhtme. Nga Sherid ibn Suvejd përcillet, se ka thënë: "Kaloi i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues-selam) pranë meje dhe unë isha ulur në këtë formë, kisha vendosur dorën e majtë pas shpine dhe isha mbështetur në pëllëmbë të dorës dhe tha: "A po qëndron ulur sikur ulen ata që kanë merituar zemërimin e Allahut?"<sup>77</sup> Nga Ebu Hurejra transmetohet, se Profeti (alejhis-salatu ues-selam) ka thënë: "Kur të ulet dikush në Diell (e në versionin e Mahledit thuhet : në hije) dhe iu largua prej tij, saqë mbetet një pjesë në Diell e një pjesë në hije le të çohet prej aty."<sup>78</sup>

---

<sup>77</sup> Transmetuan Ahmedi dhe Ebu Davudi

<sup>78</sup> Transmetuan Ahmedi dhe Ebu Davudi

*Kur mbaron takimi apo kuvendi, është e pëlqyer të thuash: “Subhanekell-llahume ue bihamdike. Esh’hedu en la ilahe il-la Ente. Estegfirruke ue etubu ilejke. (I dëlirë nga të metat je Ti, o Allah! Ty të përket lavdia! Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje! Ty të kërkoj falje dhe para Teje pendohem!)”Kur e thua këtë lutje, të falen të gjitha gabimet që ke bërë në atë takim a kuvend.*

Shënim: Kjo dua bazohen në hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejra se i Dërguari i Allahut (alejhissalatu ues-selam) ka thënë: "Kush ulet në një kuvend në të cilin janë shtuar fjalët e kota dhe pasi çohet nga kuvendi thotë: *“Subhanekell-llahume ue bihamdike. Esh’hedu en la ilahe il-la Ente. Estegfirruke ue etubu ilejke. (I dëlirë nga të metat je Ti, o Allah! Ty të përket lavdia! Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje! Ty të kërkoj Ty të kërkoj falje dhe para Teje pendohem! veçse Allahu i falë lëshimet e tij nga ai kuvend.”*<sup>79</sup>

---

<sup>79</sup> Tirmidhiu tha se hadithi është i mirë. Kjo është e saktë. Hadithin e transmeton Ibn-us-Sunni përmes Nesait në “Amal-ul-Jaum uel-Lejlah” dhe Hakimi i cili tha se hadithi është autentik sipas kushteve të Bukharit dhe Dhehebiu u pajtua me të.

*Kjo ishte përmbledhja e shkurtuar e edukatës islame.  
Allahu është Ai që udhëzon në rrugën e drejtë; dhe  
vetëm në dorën e Tij është suksesi.*

## *Përmbajtja*

<i>Parathënie.....</i>	<i>3</i>
<i>Etika e përshëndetjes islame (selami).....</i>	<i>4</i>
<i>Shtrëngimi i duarve dhe përçafimi.....</i>	<i>9</i>
<i>Bisedat e fshehta dhe ruajtja e sekreteve.....</i>	<i>11</i>
<i>Për mendjemadhësinë.....</i>	<i>12</i>
<i>Morali i zemërgjerësisë (anashkalimi i gabimeve të të tjerëve).....</i>	<i>14</i>
<i>Sunetet e Fitras.....</i>	<i>15</i>
<i>Për shkëlqjen e thinjave dhe rruajtjen e pjesës së poshtme të kokës (zverkut-qafës).....</i>	<i>18</i>
<i>Kërkimi i lejës.....</i>	<i>19</i>
<i>Kuvendimi ndërmjet dy a më shumë vetave duke përjashtuar të tjerët.....</i>	<i>19</i>
<i>Edukata e ngrënies dhe e pirjes.....</i>	<i>20</i>
<i>Të tjera rregulla që kanë lidhje me ngrënien e ushqimit.....</i>	<i>22</i>
<i>Prej normave të sjelljes brenda shtëpisë.....</i>	<i>24</i>
<i>Për gostinë.....</i>	<i>25</i>
<i>Përgojimi.....</i>	<i>27</i>
<i>Vlera e heshtjes.....</i>	<i>28</i>
<i>Për rregullat e veshjes.....</i>	<i>29</i>
<i>Për mbajtjen e unazës.....</i>	<i>31</i>
<i>Lëshimi i pantallonave përtej nyjave të këmbëve...31</i>	
<i>Ngjyrosja e flokëve dhe e mjekrrës.....</i>	<i>32</i>

<i>Veçimi i mashkullit me një femër të huaj.....</i>	<i>33</i>
<i>Për lojën dhe dëfrimin.....</i>	<i>34</i>
<i>Për rukjet.....</i>	<i>35</i>
<i>Diçka për mjekimin.....</i>	<i>37</i>
<i>Për vrasjen e gjarpërinjëve.....</i>	<i>38</i>
<i>Për vrasjen e disa kafshëve.....</i>	<i>38</i>
<i>Për pastrimin e xhamive.....</i>	<i>39</i>
<i>Për tredhjen dhe damqosjen e bagëtive.....</i>	<i>39</i>
<i>Nderimi dhe respektimi i prindërve.....</i>	<i>40</i>
<i>Prej edukatës së qëndrimit ulur dhe lutja për shlyerjen e gjynaheve, kur mbaron takimi a kuvendi.....</i>	<i>41</i>

